



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupstina Opštine
Municipal Assambly

Drejtoria për Arsim dhe Kulturë në bazë të rregullores MF-Nr 04/2017 mbi kriteret ,standardet dhe programet e financimit publik të OJQ-ve

Fton

Të gjitha Klubet Letrare, OJQ-të Kulturore, Rinore që të aplikojnë me projekt-propozim për organizimin e Orës Letrare - çmimi Dr. Ibrahim Rugova. Në projekt duhet të jenë të përshkruara qartë objektivat, aktivitetet sa më të detalizuara , përfituesit dhe buxheti.

Projekti duhet të jetë sa më i specifikuar në përshkrim elektronik ,pra të ceken në detale aktivitetet kulturore të cilat do të organizohen në Orën Letrare. Të gjitha aktivitetet - agjenda e parapara duhet të përpilohet në bashkëpunim me Drejtorinë për Arsim dhe Kulturë.

Përparësi do të kenë këto Organizata që :

1. Që kanë bashkëpunim me një apo më shumë Klube ose organizata që merren me aktivitete të tilla .
2. Organizatat që kanë dëshmi për aktivitete të tilla.
3. Përparësi do të kenë projektet të cilat e kanë përshkrimin e qartë dhe **buxhetin e specifikuar.**
4. Përparësi do të kenë organizatat që janë nga Komuna e Istogut .

Projekt propozimi i dorëzuar duhet te përmbaje :

- Në projekte duhet të përfshije lokacionin, kohëzgjatjen e implementimit,numrin e aktiviteteve Kulturore etj.
- Projekt propozimi duhet të jetë i kufizuar deri në 1700 euro.
- Një kopje që posedon regjistrimin e OJQ - së,kopjen e certifikatës fiskale
- Një kopje të llogarisë bankare të OJQ-së dhe kopjen e letërnjoftimit te menaxherit të projektit.

- Projektet nuk do te përkrahen nëse nuk kane përputhshmëri me kriteret e kësaj thirrje .

Projekt - propozimet do të vlerësohen nga një komision ne përbërje prej pese anëtarëve .

Afati përfundimtar për dorëzimin e projekteve është 24.07.2018.

Projektet që aplikojnë pas këtij termini nuk do të shqyrtohen. Projektet duhet të dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar Nr 100.

**Drejtori i DAK
z.Hajrush Shoshi**

